



| | |
|---|---------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT | |
| AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE | |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | Nr Prot |
| Dep. AKK-DPK | Br Prot 01-2032/14 |
| Dep. | Prot No |
| Nr. i faq. | Data |
| Broj stranica 2 | Datum 03.06.2014 |
| Nr. pages | Date |
| | 03.06.2014 |
| PRISHTINE | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|-------------------------------|--|
| DATË/A: | 29.05.2014 |
| REFERENC-Ë: | AKK-DPK |
| PËR/ZA/TO: | z. Riza Krasniqi Zyrtar i Brendshëm i Lartë i Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik |

I nderuari z. Krasniqi,

Lidhur me kërkesën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit (DPK-03-1134/14), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), Agjencia kundër Korrupsionit, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eproreve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Prandaj, bazuar në kërkesën tuaj, se a paraqet konflikt interesi ushtrimi i funksionit si anëtar i bordit/ Kryesues i Komitetit të Auditimit në NKP/ Trafiku Urban-Prishtinë, krahas funksionit tuaj publik si Zyrtar i Brendshëm i Lartë i Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë, në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kemi nxjerr këtë:

OPINION

Nuk lejohet ushtrimi i funksionit publik si anëtar i bordit/ Kryesues i Komitetit të Auditimit në NKP/ Trafiku Urban-Prishtinë, krahas funksionit tuaj publik si Zyrtar i Brendshëm i Lartë i Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë për arsye se paraqet kufizim në ushtrimin e funksionit publik.

Arsyetim

Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit pozita juaj si Zyrtar i Brendshëm i Lartë i Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Në bazë të nenit 8 të këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të parandalojnë dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.



Prandaj, pyetja juaj për ushtrimin e funksionit të dytë si anëtar i bordit/ Kryesues i Komitetit të Auditimit në NKP/ Trafiku Urban-Prishtinë, krahas funksionit tuaj publik si Zyrtar i Brendshëm i Lartë i Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë, në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nuk lejohet për arsye se paraqet kufizim në ushtrimin e funksionit publik.

Kjo parashihet me nenin 16 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ku thuhet se, zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, këtu përjashtohen subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit.

Bazuar në këtë dispozitë, pozita juaj si Kryesues i Komitetit të Auditimit në Ndërmarrjen Komonale Publike Trafiku Urban-Prishtinë, cilësohet si funksion në organe menaxhuese dhe lidhet pikërisht me nenin e lartcekur.

Andaj, konform asaj që u tha më lartë, iu rekomandojmë që të ndërmerrni të gjitha masat konform këtij opinioni, që të parandaloni konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|-------------------------------|---|
| DATË/A: | 30 .05.2014 |
| REFERENC-Ë: | AKK-DPK-07/14 |
| PËR/ZA/TO: | z. Hasan Mehmeti, Sekretar në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A – Prishtinë. |
| CC: | z. Hamdi Jaha, Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A - Prishtinë. |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik |

I nderuari z. Mehmeti,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “*bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave*”, (Neni 19 (paragrafi 1.5) i Ligjit nr.04/L-051). Në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, për rastin e caktuar, kemi nxjerrë këtë:

OPINION

Ekziston kufizim në ushtrimin e funksionit publik si Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A – Prishtinë dhe angazhimit si Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

ARSYETIM

Agjencia Kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z. Hasan Mehmeti - Sekretari i Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A, me nr. të protokollit AKK-03/1525/14, me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, që të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë z. Hamdi Jaha, i cili ushtron funksionet publike si Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A - Prishtinë dhe angazhimit si Drejtor i Drejtoratit të Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Nr. 04/L-051, sipas nenit 6 të këtij Ligji, konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Rrjedhimisht, neni 8 (paragrafi 1,2,3,4,5,6) përcakton detyrimet e zyrtarit të lartë për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Ndërsa, neni 16 i këtij ligji, përcakton kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik. Në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, *"zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë dedikohet për shkak të funksionit"*.

Në anën tjetër, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ka paraparë disa kushte për Pavarësi që duhet të plotësohen nga një person për të shërbyer si Drejtor, të përcaktuar shprehimisht në nenin 17 paragrafi (2) të këtij Ligji

Të gjithë drejtorët përveç KE duhet të jenë të pavarur. Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

d) është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;

g) përfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;

k) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;

l) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutine, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

Prandaj, ju rekomandojmë që të veproni konform këtij Opinioni të bazuar në Ligj, për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë zyrtarin e lartë në gjendje të konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Me respekt!